

Zamputti është i njohur për studimet e përkthimet e tij brilante për historinë e letërsisë shqiptare, Nuk ka aspak dyshim se ky emër formoi dhe frymëzoi gjenerata të ndryshme studiuesish të rinj përmes publikimeve të tij. Puna e tij është shumë frytdhënëse për historiografinë shqiptare. E kam cekur edhe më herët se Injac Zamputti është gati "i vetmuar" për historiografinë shqiptare në llojin e punës së tij, sepse mënyra, metoda dhe dija e tij reflektojnë në publikimet e tij edhe sot e tutje. Vepra që kemi në dorë është një vepër tejet e rëndësishme për të kuptuar dhe plotësuar veprat studimore apo përkthimet e Zamputti-t, duke u futur në brendësi të jetës së tij.

Albanisches Institut dhe shtëpia botuese "Faik Konica" kanë botuar disa vepra të Zamputti-t dhe ka marrë përsipër të botojnë veprën "Kujtime". Këtë vepër e ka përgatitur në këtë formë Jozef Zamputti, i biri i Injacit. Ky libër është i ndarë në dy pjesë: pjesa e parë është: "Mirazhe - Arritje – Zhgënjime 1910-1944" dhe pjesa e dytë "E pakryemja sinfoni skëterrore, 1945-1992". Libri është i pasuruar me shumë fotografi nga jeta dhe familja e Injac Zamputti-t. Albanisches Institut dhe Shtëpia Botuese "Faik Konica" kanë botuar deri më sot disa vepra të Injac Zamputti-t.

*Albert Ramaj*

Këto kujtime autori i ka lënë në dorëshkrim; kuptohet me makinën e shkrimit të asaj kohe. Siç vihet re, pjesën e parë (1910-1944) autori e ka shkruar me gjuhën letrare; kjo sepse është shkruar në vitet '80. Ndërsa pjesën e dytë e ka shkruar në fillimet e viteve '90 dhe është kthyer në dialektin e veriut, doemos mjaft të zbutur. Gjatë kujtimeve të pjesës së parë janë shtuar nga ana jonë disa punime të autorit të asaj periudhe që ndihmojnë për të kuptuar e shpjeguar më mirë mendësinë e kohës dhe të autorit. Në pjesën e dytë autori vetë ka përfshirë një studim të tij me titull "Mbi autoktoninë e shqiptarëve në Ballkan nga legjenda në histori".

*Jozef Zamputti*

"Kështu ndodhi që, prej vitit 1949 dhe deri në fund të jetës, si fushë kryesore e kontributit të Injac Zamputit në shkencën dhe kulturën shqiptare spikati ajo e diplomatikës."

*Aurel Plasari*

"Në penën e Injac Zamputtit, historia e Shqipërisë vazhdonte të zhvillohej në lidhje të ngushtë me Republikën e Venedikut e me atë të Raguzës, me mbretërinë e Napolit apo me atë të Spanjës, me mbretëritë e Francës, Gjermanisë, Hungarisë e sigurisht me Papatin. Është edhe falë tij, që historia e Shqipërisë në shekujt e sundimit osman mbeti një histori evropiane dhe nuk u katandis në një kronikë provinciale otomane. Pra, Historia e Shqipërisë si një histori evropiane."

*Pellumb Xhufi*

"At Giuseppe Valentini S.J (1900-1979) dhe Injac Zamputti (1910-1998), mësuesi dhe dishepulli, janë pa asnjë dyshim dy themelvënësit dhe njëkohësisht dy diplomatistët e pambërritshëm të botimit të burimeve dokumentare për historinë e Shqipërisë."

*Kastriot Marku*

Duke patur si qëllim kryesor të shkruajë kujtime, në formën e tyre të përjetshme historike, letrare dhe shkencore, Zamputti e katë qartë detyrën e madhe që i ka ngarkuar vetes në moshë të rënduar nga puna dhe vitet dhe, në mënyrë të saktë e të qartë, i rri konsekuent gjithçkaje në parimin letrar, historik e vërtetësinë jetësore.

*Musa Vyshka*

Injac Zamputti

**KUJTIME**

NJERËZ-FAKTE-NGJARJE

Injac Zamputti **KUJTIME** NJERËZ-FAKTE-NGJARJE

ISBN 978-3-9524201-7-1  
ISBN

albanisches  
institut

FAIK KONICA

**INJAC ZAMPUTTI**

## **KUJTIME**

**NJERËZ - FAKTE - NGJARJE**

Kujtimit të babës së dashtun,  
***djali dhe vajzat.***



INJAC ZAMPUTTI

# KUJTIME

NJERËZ - FAKTE - NGJARJE

albanisches  
Institut

FAIK KONICA

St. Gallen-Prishtinë 2020

INJAC ZAMPUTTI

**KUJTIME**

NJERËZ - FAKTE - NGJARJE

**Përgjegjës të këtij botimi:**

Jozef Zamputti

Albert Ramaj

Nazmi Rrahmani

Zef Ahmeti

Kastriot Marku

© Albanisches Institut

Albanisches Institut  
Postfach 7  
CH-9001 St. Gallen  
[www.albanisches-institut.ch](http://www.albanisches-institut.ch)  
[info@albanisches-institut.ch](mailto:info@albanisches-institut.ch)

(CIP) Schweizerische Landesbibliothek  
ISBN: 978-3-9524201-7-1

SHB Faik Konica  
Rr. Ganimete Tërbeshi nr. 20  
10000 Prishtinë  
[konica\\_faik@hotmail.com](mailto:konica_faik@hotmail.com)

(CIP) Biblioteka Kombëtare e  
Kosovës "Pjetër Bogdani"  
ISBN: 978-9951-06-801-7

## PËRMBAJTJA

PARAFJALA E BOTUESIT .....	7
HYRJE .....	15
NË MOSHËN E FËMIJËRISË .....	19
NGA ADOLOSHENTA NË RINI.....	40
NË MOSHËN E RINISË .....	58
DY PORTRERE NË OBJEKTIVIN TIM .....	73
ATË GJERGJ FISHTA .....	91
VALENTINI DHE ALBANOLOGJIA SAVERIANE.....	112
GJON KOLË KUJXHIJA .....	123
AORIST I SHQIP.....	129
NISË BOTIMI I NJIJ VEPRE MONUMENTALE ALBANOLOGJIKE .....	150
ZHGËNJIME PAS ZHGËNJIMESH .....	162
KURSIVI I IM .....	235
RRUGA E SHTRUEME ME LULE PËR ME HYMË NË FERRIN KOMUNIST .....	237
NISIN MUNDIMET E FERRIT .....	254
I MBIKQYRUN, I PROVOKUEM, I POSHTNUEM .....	268
MBI AUTOKTONINË E SHQIPTARËVE NË BALLKAN NGA LEGJENDA NË HISTORI .....	279
I MBIKQYRUN, I PROVOKUEM, I POSHTNUEM .....	290
GËZIME PARRIZI NË MUNDIMET E FERRIT .....	298
ÇASHTJE TË NDRYSHME .....	337
LUFTA IDEOLOGJIKE NDAJ MEJE DHE RRJEDHIMET E SAJA .....	345
FLETË NGA DITARI .....	354
KOHA E PENSIONIT .....	364
PREJ EPILOGUT NË PROLOG.....	370
FLETË DITARI TË PAPUNËSISË SIME.....	372
PASTHËNIE .....	405



## PARAFJALA E BOTUESIT

Harresa e qëllimtë apo e paqëllimtë mund të shkaktojë hutim për brezat e ardhshëm, nëse nuk dihet se si kanë rrjedhur gjërat gjatë një periudhe të caktuar. Kështu mund të ndodhë edhe me periudhat në të cilat ka jetuar e punuar Injac Zamputti. Jeta e tij ishte e bujshme dhe përjetoj shumë ndryshime historike, para, gjatë e pas Luftës së Parë Botërore, po ashtu edhe me Luftën e Dytë Botërore, jeta e vështirë gjatë komunizmit, por edhe puna aq e frytshme gjatë asaj periudhe.

Vendlindja e tij ishte Shkodra, qytet me të cilin ishte lidhur shumë. Zamputti kishte babain italian, kurse nënën shqiptare.

Zamputti është i njohur për studimet e përkthimet e tij brilante për historinë e letërsinë shqiptare. Nuk ka aspak dyshim se ky emër formoi dhe frymëzoi gjenerata të ndryshme studiuesish të rinj përmes publikimeve të tij. Puna e tij është shumë frytdhënëse për historiografinë shqiptare. E kam cekur edhe më herët se Injac Zamputti është gati "i vetmuar" për historiografinë shqiptare në llojin e punës së tij, sepse mënyra, metoda dhe dija e tij reflektojnë në publikimet e tij edhe sot e tutje.

Vepra që kemi në dorë është tejet e rëndësishme për të kuptuar dhe plotësuar veprat studimore apo përkthimet e Zamputti-t, duke u futur në brendësi të jetës së tij.

Albanisches Institut dhe Shtëpia Botuese "Faik Konica" kanë botuar disa vepra të Zamputti-t dhe kanë marrë përsipër të botojnë veprën "Kujtime". Këtë vepër e ka përgatitur në këtë formë Jozef Zamputti, i biri i Injacit. Ky libër është i ndarë në dy pjesë: pjesa e parë është: "Mirazhe - Arritje – Zhgënjime 1910-1944" dhe pjesa e dytë "E pakryemja sinfoni skëterrore, 1945-1992". Libri është i pasuruar me shumë fotografi nga jeta dhe familja e Injac Zamputti-t. Albanisches Institut dhe Shtëpia Botuese "Faik Konica" kanë botuar deri më sot disa vepra të Injac Zamputtit, prandaj duam të falënderojmë për bashkëpunimin Nazmi e Arber Rrahmanin. Një falënderim i veçantë duhet shprehur për Zef Ahmetin, për përgatitjen e këtij libri.

Do të vazhdojmë edhe më tutje me botime të Zamputti-t.

Pjesërisht shpenzimet e këtij botimi i mbuloi autori i këtyre rreshtave, si respekt për punën dhe veprën e Injac Zamputti-t.

Albert Ramaj, Zürich 2020.





Ky vëllim u përgatit për shtyp nga i biri i autorit, Jozef Zamputti.

*Këto kujtime, në formë kronike, autori i ka ndarë në dy pjesë: "Mirazhe - Arritje - Zhgënjime" dhe "E pakryemja sinfoni skëterrore". Pjesën e parë (1910-1944) autori e ka shkruar me gjuhën letrare; kjo sepse është shkruar nga fundi i viteve '80. Ndërsa pjesën e dytë (1945-1992) e ka shkruar në fillimet e viteve '90 dhe është kthyer në dialektin e veriut, doemos mjaft të zbutur. Në fillim po sjellim një përmbledhje të materialeve të gazetës "Panorama" dt. 30.11.2009, të Radio Vatikanit dt. 11.12.2009 dhe një letër (pas vdekjes), për mospranimin e autorit për të bashkëpunuar me Policinë Sekrete (Sigurimin). Në pjesën e dytë autori vetë ka përfshirë një studim të tij me titull "Mbi autoktoninë e shqiptarëve në Ballkan nga legjenda në histori". Gjatë kujtimeve të pjesës së parë janë shtuar nga ana jonë disa punime të autorit të asaj periudhe që ndihmojnë për të kuptuar e shpjeguar më mirë mendësinë e kohës dhe të autorit. Shënimet tona do të jenë me siglën J.Z.*

**JOZEF ZAMPUTTI**

## **PANORAMA - 30.11.2009**

*"Pranova edhe me vdekë, por kurrsesi të bashkëpunoj me ta".*

... Dikur kam firmosur një dokument pa m'u dridhë dora. U kam thënë "jo" zyrtarëve të sigurimit që deshën me më rekrutue ... Pranova me vdekë, por me ra në atë humnerë, kurrsesi. Hijet e asaj mbramje të zezë më ndoqën gjithë jetën ...

*"Rrëfimi i Injac Zamputtit: Pse kundërshtova të spiunoj Eqrem Çabejn - Kujtimi i atyne çasteve më ban me u dridhë dhe më pengon të them çdo gja me hollësi".*

... Bashkëkohësit e albanologut të njohur pohojnë se regjimi e ka parë me sytë e njerksës ... Tërë jetën mbeti në periferinë e vëmendjes së opinionit zyrtar. Miqtë dhe të njohurit e lidhin këtë me origjinën e tij italiane. Por Zamputti nuk mbeti i izoluar vetëm prej saj ... Guximi për t'i thënë jo rekrutimit nga sigurimi i shtetit e vuri në shënjestrën e organeve represive. Që këtej mbeti i padëshirueshëm për pushtetin, por jo vetëm kaq.

... Albanologu i njohur nuk duhej të fliste për këtë me askënd. Ndryshe, dihej çfarë e priste. Andaj mbylli gojën dhe vazhdoi punën me vullnet të jashtëzakonshëm.

*"Studiuesi", spiuni i munguar i dosjes "Çabej",*

Në dosjen “Çabej” emri i Injac Zamputtit përmendet disa herë. Shënimet e zyrtarëve të sigurimit të destinuara për kapitullin “Bashkëpunëtorë të fshehtë” në të gjitha raste e pranojnë pa mëdyshje: Albanologu nuk pranoi statusin e agjentit ... Dueli vazhdoi për disa vite ... Në “Kujtimet” e Zamputtit përshkruhet vetëm njeri nga presionet e zyrtarëve të policisë sekrete. Ndërkaq në dosjen “Çabej” janë regjistruar me dhjetra të tilla që shtrihen në një hark kohor 10 vjeçar. Në të gjitha raportet kur përmendet emri i Zamputtit shprehet “Jo”- ja e prerë përballë presionit të tyre ... “Të thirret përsëri”, “Të shtërngohet me fort”, “T’i bëhet presion për familjen” : Këto janë vetëm disa nga detyrat që eksponentët e policisë sekrete kanë lënë në raportet zyrtare me siglën “Tepër sekret”. Kaq e rëndësishme ka qenë si çështje mospërfshirja e Zamputtit, saqë me të është marrë drejtpërdrejt titullari i dikasterit. Në një shënim të tij bëhet i ditur urdhëri që me Zamputtin të angazhohej nga afër zëvendësministri Mihallaq Ziqishti. Por edhe angazhimi i numrit dy të sigurimit nuk ndryshoi gjë në sjelljen e studiuësit fisnik.

## **RADIO VATIKANI - 11.12.2009**

*“Ai që nuk pranoi të rekrutohej”*

... Në dosjen “Çabej” ndeshen një sërë emrash të fshehura pas pseudonimeve të përçudnuara: “Dhelpra”, “Edija”, “Prurësja”, “Gjevreku” etj. ... Por nuk munguan Njerëz që, duke vënë në rrezik veten e familjet e tyre, nuk pranuan të zhyteshin në llumin e spiunimit ... Nga kjo dosje del në dritë edhe emri i Injac Zamputtit. Ç’do të thoshte të mos pranoje të bëhehe spiun në kohën e diktaturës, këtë e dinë mirë vetëm ata që, heroikisht, nuk pranuan të bëheshin hafije, duke ia mbyllur vetes të gjitha rrugët, veç asaj që çon drejt Mbretërisë së amshuar. Pikërisht me këtë Mbretëri lidhet letra e mëposhtme shkruar nga i biri i Injacit, Jozefi. Plot me krenari të ligjshme, nis me titullin thellësisht prekës:

**FALEMINDERËS, BABË!**

(Letër mbas vdekjes)

Pas botimit në gazetën “Panorama, e lexon për ne vetë Jozefi:

“Po ta shkruaj këtë letër në dialektin e dashtun tand (edhe temin) me të cilin linde dhe u rrite. Jam në dhomën ku mbylle sytë për herë të fundit, tashti me kompjuter, ku nuk reshte së rrahuni makinën e shkrimit derisa nuk pate ma forcë e, mbasandej, me dorën që dridhej duke shkruar gjithnjë për Shqipninë e Historinë e saj.

E prisja këtë pohim të dokumentuem: AI NUK PRANOI TË REKRUTOHEJ. Ku e gjete atë forcë në atë kohë aq të rrezikshme? Ti, aq i brishtë, aq i butë e i sjellshëm? Vetem te besimi i patundun te Zoti e te lutjet që nuk i ndave gjithë jetën. Këto na i mësove edhe ne dhe ishin të vetmet për me kalue dallgët e jetës. Po due me të kujtue ma poshtë se e kam gjetë një shënim-porosi, që kishe lanë në një fletë të vogël për nipin tand Marin dhe për të cilin nuk më kishe folë asnjëherë. E ruej si relike:

M.

*Në qoftë se ti je duke lexuar këto fjalë që unë po shkruaj për ty, ti tashmë duhet të jesh rritur, duhet të jesh me arësim dhe i ditur, duhet të jesh duke vazhduar ciklin e jetës sate, kurse imi do të ketë mbaruar.*

*Shkruaj për ty që të të lë jo kujtimin tim, - sepse në qofsh edukuar siç është edukuar biri im, babai yt, ti kujtimin e gjyshit do ta mbash deri në vdekje – por që të të lë diçka të qartë nga mendimet e mija. Dhe do të jem i lumtur në jetën tjetër, që unë vazhdoj ta quaj të vërtetë, nëse do të të ndihmoj ndopak për të kaluar dallgët e jetës, pa u mbytur në to. Shpesh herë unë kam qenë duke u mbytur në dallgët e jetës sime dhe, në qoftë se, do të shpëtoj deri në fund, këtë ia detyroj asaj dore që unë vazhdoj ta quaj hyjnore.*

Për presionet për rekrutim nuk na ke folë asnjëherë, për të mos na shqetësue, por i ke mbajtur për vedi. Vonë, shumë vonë, me ardhjen e demokracisë, fillove të më tregosh për atë stuhi që ke kalue. E ke lanë edhe në kujtimet e tua. Gjithnji mendoja: po sikur atë firmë për mosbashkëpunim ta kenë përdorë në kahun e kundërt? Por ja që doli e vërteta. Ata që ta morën firmën e dërguen te shefat e tyne për me tregue se ti nuk rekrutoheshe, nuk mund të baheshe spiun i tyne. Pasojat? Frika e madhe për vedi e për familjen të shoqnoi gjithë jetën. Sapo ndigjoje ndonjë batutë kundra regjimit, qoftë edhe nga pjesëtarët e familjes, e ndaloje bisedën ose dilje në dhomë tjetër.

Ma vonë erdhi stuhia e '67. Dëshën me të fundosë por, siç duket, ndonjë urdhën nga nalt tha: "Ilereni të punojë". Dhe ti u zhyte gjithnji e ma thellë në botën e dokumenteve të mesjetës, në botën e Shkrimtarëve të Vjetër, në shoqni me Buzukun, Bogdanin, me relacionet e Budit e Bardhit, me leximet e vështira të mbishkrimeve të vjetra etj. Dhe prej dorës tande dolën shumë punime e, sidomos, 10 vëllime me dokumente të transkriptueme e të përkthyme, një burim i pashtershëm për Historinë Mesjetës shqiptare. Doemos, t'i sillnin të tjerët fotokopjet e mikrofilmat nga jashtë e ty, edhe pse të ftonin në konferenca të ndryshme, nuk të lanë asnjëherë të dilje nga Shqipëria.

Por, për ty, kobi ma i randë ishte mbyllja e kishave, ndalimi i fesë. Nga muret e shtëpisë sonë u hoqën fuguret që u ruejtën në fundet e arkave. Na mësove si me u lutë në heshtje e si me e ba kryqin fshehtas në krahnor.

Të lanë gjithë jetën në një shtëpi me katër familje në një korridor me një banjë të përbashkët. Me sa duket që me të kontrollue e me të mbikqyrë ma mirë. Punoje në një tavolinë të vogël, shpesh në prehën, i mbështjellë me një batanije në ditët e ftofta të dimnit. Por, me punën tande e me heshtjen tande, dihte me i përballue dallgët që të vinin nga të gjitha anët. Ishe në një pozicion shumë të vështirë: për “ata” matanë Adriatikut, ti punoje për “këta”, ndërsa për “këta”, ti punoje për “ata”. “Këta” të quejtën edhe “buburcë e zezë e Vatikanit”.

Asnjëherë nuk ta njoftën laurën e Universitetit të Triestes; shkove pa marrë asnjë titull, megjithëse shumica të nderonin me fjalën “profesor”.

Kur erdhi demokracia, kërkove takim dhe u rrëfeve me atin tand shpirtnor Atë Gardinin (që për mrekulli të Zotit ishte ende gjallë) dhe “ata” të besuen (sepse rrëfimi asht i shejtë) se ti nuk ishe përlye asnjëherë. Shpërtheve menjëherë në fillimet e viteve '90 me dy libra: “Ekskursion në dy vepra të Kadaresë” dhe “Fishta – koha, njeriu, vepra” e me artikuj të tjerë derisa mbylle sytë.

Faleminderës, babë! Këto fjalë i drejtohen edhe nanës sonë të dashtun që dijtë me përballue bashkë me ty gjithë këto stuhi e të qëndroi gjithnji pranë. Pushoni në paqë! Na keni lanë pasuninë ma të vlerhtë: ndershmërinë.

P.S. Këto fjalë mund t'i kishte shkruar secila nga pesë motrat e mija e, ndoshta, edhe ma mirë.

*Shtesë e Radio Vatikanit:* Duke shfletuar “Komedinë Hyjnore” të Dantes, gjejmë edhe adresën e mundshme, për dërgimin e kësaj letre të jashtëzakonshme: Injac Zamputti, Parriz, Qielli i katërt i Diellit; pranë shpirtnave të ditun (e të pashitun).

Pjesa e parë

**MIRAZHE - ARRITJE - ZHGËNJIME**

1910 – 1944



## HYRJE

(e Autorit)

Të përpiqem të grumbulloj dhe të paraqes me shkrim njerëzit, faktet dhe ngjarjet që kanë kaluar dhe janë vërtetuar gjatë jetës sime të gjatë është sigurisht një punë e pamundur për mua, në moshë të kaluar, në pragun e përfundimit të detyrave të mia njerëzore. Sikur të kisha mbajtur ditare të rregullta, në fazën e pjekurisë sime, gjatë gjashtëdhjetë e sa vjet pune prodhuese mendore, do ta kisha disi më të lehtë. Megjithatë brendia shpirtërore njerëzore ruan visarin e madh të kujtimit e të emocioneve dhe me këtë çelës mund të hapen edhe më të kyçurat kasaforta të së kaluarës.

Do të përpiqem, pra, të nxjerr nga thellësitë e shpirtit tim ngjarje, fakte dhe njerëz që kanë kaluar pranë meje ose në të cilat e me të cilët kam marrë pjesë drejtpërdrejt në veprim. Do të ndjek metodën e veçantë që i kam caktuar vetes në këto kujtime, dmth: vetja ime, qysh nga fëmijëria deri në pleqëri, të shërbejë jo për të tentuar një autoportret, por për të nxjerrë në dritë vlerat dhe të metat e shoqërisë në gjirin e së cilës u linda, u rrita dhe veprova. Synimi i kësaj metode është që çdo gjë imja, edhe më intimja, të jetë e të dalë sa më përgjithësuese dhe të marrë karakter sa të jetë e mundur informativ dhe edukativ për breznitë që rriten, sigurisht në kushte të ndryshme nga të miat, por që fizikisht duhet të kalojnë nëpër fazat nga kam kaluar unë dhe çdo qenie njerëzore : qysh nga fëmijëria, nëpër adoleshencë e rini dhe deri te moshë madhore e në pleqëri.

Faktet njerëzore janë kaq komplekse dhe, njëkohësisht, kaq të ngjashme edhe pse jo të barabarta, saqë, edhe pas mijëra vitesh, mund të shohim të pasqyruara në to disa anë të vetes sonë. Përndryshe si do të na interesonin, ta zemë, heronjtë e Homerit?

[Shënim: Po sjellim parathënien e melodramit "Damjani Himarjot" të shkruar nga vetë autori, botuar në numrin përkujtimor të "Lekës" më 1937. Nuk i ka vënë në fund emrin, siç ishte zakoni, vetëm "Redaksija". Kemi ruajtur grafinë e atij botimi duke shpjeguar ndonjë fjalë a shprehje. – J.Z.]





## DAMJANI HIMARJOT

### **PUNIM LETRAR I RRETHIT TË LEKËS NË RASËN E KREMTIMEVE TË 25 VJETVE TË PAVARSËS KOMBTARE**

*Melodrami qi paraqesim âsht fryti i së perkohshmes sanë<sup>1</sup>.*

*Nuk besojmë se do të na e marri per të keq gjikimin tanë<sup>2</sup> Auktori, i cili mâ se një herë na tha se mos t'ishte kënë arkivisti i Lekës me e gjetë atë fëtyrë sympathike të Damjanit nuk do të kishte marrë një personalitet dramatik në mende, në zëmer, në pendë të ti.*

*Gegë auktori, toskë Damjani.*

*Shkodranë njëni, himarjot tjetri.*

*Por epizodi i Damjanit e i burravet të Himarës e ndezin zëmren e njëj shkodrani që rrî dita me ditë në kuvend e në perpjekje<sup>3</sup> me Malet e Shkodrës, pse analogjina të çuditshme burrnije, bese e zakoni gjenden nder këto dy ekstreme gjeografike shqiptare. E âsht e arësyeshme: janë bijt e njëj nane.*

*Malsorët në perpjekje të padame me malazez, i a ruejn Shqipes të patrazueme çerdhen qi ka ngulë nder male të tyne.*

*Himarjott n'ânë tjetër, në perpjekje me grek i a ruejten çerdhen Shqipes Vlonjake.*

*Të dàm e të paprîs të parët, bashkohen kur t'i lypë Shqipnija e kan në krye një burrë të vetin.*

*Të dàm e të paprîs të dytët, bashkohen kundra saraçenvet e ndo'j burrë i veti u a ndezë zëmrat, e nuk pritojnë të flijohen.*

*Të dyja ânët e dijn se nuk munden me e fitue shpejt lirën e humbun, por së paku shkëndin e lirës e ruejn nder zëmra.*

*Njiqind vjet? Dyqind? ...*

*Mâ e mâ, deri sa të vijë dita. Kështu menduen e kështu vepruen.*

*Âsht pergjakë e kjàn Shqipnija. I kanë ikë o i janë farue djelmt. Anî<sup>4</sup>: ka asish, një nder njimij, qi e ndiejn në zëmer të vet gjenin shqiptar, e kur u bjen rasa, Scevola të rij, perballojnë rrezikun e gjaku i tyne, pikë-pikë, ndezë zëmrat shqiptare.*

*E grueja?*

*Kambë për kambë me trima<sup>5</sup>, malcorja e himarjotja ku e lypi puna aty u gjet.*

---

<sup>1</sup> sanë – sonë.

<sup>2</sup> tanë – tonë.

<sup>3</sup> perpjekje – (këtu) takim, lidhje

<sup>4</sup> anî – s'ka gjë

<sup>5</sup> trima – (këtu) burra

*Mos t'kishte kënë dora e grues shqiptare qi në pëlhurë të kuqe të qitëte Dykrenaren, e tash e mâ vrap<sup>6</sup>, t'u a paraqitëte burravet per bashkim, Flamuri s'do t'ishte gjetë gadi per Deçiq e Vlonë.*

---

<sup>6</sup> *tash e mâ vrap* – shpejt e shpejt

## NË MOSHËN E FËMIJËRISË

Kam lindur në Shkodër më 12 shkurt 1910, në kohën më të mprehtë të kryengritjeve shqiptare për të rifituar pavarësinë dhe për të siguruar individualitetin shqiptar përballë synimeve gllabëruese të fqinjve ballkanas. Kështu që fëmijëria ime më ka kaluar nëpër të zezat e Rrethimit të Shkodrës (1912-13), nëpër kohën e shkurtër të Internacionalit (1913-14), nëpër pushtimin austriak gjatë Luftës së Parë Botërore (1916-18), nëpër fazën e dytë të Internacionalit (1918-19) dhe nëpër fazat e revolucioneve të brendshme në kërkim të stabilitetit të shtetit shqiptar (1920-24).

Gjyshi im, Giuseppe (Xhuzepe) Zamputti (e shkruanim edhe Zamputi), mjek i ikur nga Italia më 1870, doli në Raguzë (Dubrovnik) ku u martua me Luigjan nga familja e njohur raguzane Raçiç. Prej këndeje kaloi në Turqi për të gjetur punë. Qe dërguar prej Portës së Lartë në Shqipëri me detyrën e mjekut bashkiak në Kavajë. Më pas kaloi në Durrës. Në Kavajë lindi babai im, Romolo, më 1876 dhe qe pagëzuar në Durrës më 29 maj të atij viti, siç e dëshmon *Fedja apo Dëftesa e Pagëzimit* lëshuar prej personalitetit të njohur në historinë e Shqipërisë, Dom Nikollë Kaçorri. Kur gjyshi arriti moshën e pensionit erdhi familjarisht në Shkodër ku, ndërkohë, babai im studionte teologjinë në Seminarin Papnor. Shkodra, aso kohe, paraqiste një mjedis disi më të ngritur se vendet e tjera. Veç të tjerash (kleri, kishat, shkollat etj.), kishte edhe një elitë qytetare (tregtarë dhe familje që frekuentonin tregjet e Italisë, Turqisë etj.), por sidomos kishte një kolektiv përfaqësish konsullorë të shteteve evropiane që interesoheshin për Ballkanin. Kishte disa farmacistë që kishin hapur farmacitë e para (Perikli Mozali, Simon Tironi etj., gjithësej 6 farmaci). Kështu që gjyshi im, siç e dëshmon edhe një fotografi, shërbente pranë farmacisë së Perikli Muzalit te Fusha e Çelës. Gjyshi vdiq më 1900.

Nga ana e nënës kam gjak shqiptar. Ajo qe bijë e një malësori të rënë në Shkodër prej Temalit. Kishte qenë martuar më parë, vajzë gjashtëmbëdhjetë vjeçare, në Ulqin te një tregtar i quajtur Lush Toma. Njëzetvjeçare mbeti e vejë dhe u kthye në Shkodër te nëna e vet, duke sjellë me vete vajzën e njomë, motrën time, Çile Toma, e cila, pastaj, në fëmijërinë dhe rininë time, pati një peshë kryesore në edukimin tim.

Nëna ime, Nine (Antonjeta), përveçse grua punëtore dhe e ndershme, ka qenë edhe e bukur, siç e dëshmojnë edhe fotografitë që ruaj. Kjo shpjegon se si një bijë malësori tërhoqi vëmendjen e familjes *lëtime* Zamputti.

Babai im, me nënën e vet dalmatine, banonte në një shtëpi komshi me mamën time (unë e kam quajtur *mamë* dhe prandaj këndeje e tutje do ta lakoj emrin e dashur sipas kësaj trajte). Duke e parë këtë nuse të vejë, me ato cilësi e veti që thashë, e kërkoi për shoqe të jetës. Ishte një gjë shumë e

rrallë, për të mos thënë unike, në mjedisin shkodran ku fejesat e martesat bëheshin jo në këtë mënyrë të drejtpërdrejtë por me anën e ndërmjetësve (shkuesve) ku më shumë peshonte interesi ekonomik i të dy palëve se sa vlera shpirtërore e çifteve që do të krijonin familjet e reja.

Kur ia thanë mamës, kjo në asnjë mënyrë nuk deshi të pranonte sepse, siç ma thoshte pastaj ajo vetë, e konsideronte veten të padenjë për një *lëtin* që punonte në konsullatën italiane me detyrën e Shefit të Postës. Duhet ditur se, në regjimin turk, përfaqësitë konsullore kishin të drejtën të mbanin zyrë postare ku, veç korrespondencës zyrtare që shoqërohej me *kavaz* (roje) deri në kufi të shtetit, mund të gjenin shërbim edhe vendasit privatë. Mama nuk mund ta mendonte si mund të ishte e denjë t'i rrinte përkrah atij djali që frekuentonte shtresat më të larta qytetare. Ajo, bijë malësori, e vejë me një vajzë dhe me nënën të panjeri e plot halle për jetesë, si të shkonte e t'ia zinte derën atij djaloshi të dalluar? Veç kësaj, ajo e ndiente veten shumë poshtë nga ana kulturore (jo se ishte analfabete, sepse në Shkodër kishte mundësi për arsim, sado rudimental, edhe për vajzat), dhe nuk mund ta mendonte si mund të ishte gruaja e një burri me gjithë atë kulturë, që dallohej sidomos si njohës i gjuhëve të huaja dhe që kishte pasur rastin të bënte një udhëtim edhe në New York. Çdo gjë do të rregullohej në shtatë vjetët e bashkëjetesës që mama kaloi me babain tim: ai e bëri mamën një nga më të paraqitshmet nuse të elitës shkodrane, e veshi me rrobat më të bukura të modës evropiane të atëhershme dhe e paraqiti nëpër sallonet ku mbledhej elita për të kaluar mbrëmjet festive. Megjithatë, babai deshi që mama t'i kishte përherë të gatshme rrobat karakteristike shkodrane dhe, për të hequr mallin e rinisë dhe të kontaktit të parë shpirtëror me mamën, shpesh e detyronte t'i vishte ato rrobe nëpër shtëpi. Kur mama ma thoshte këtë, fytyra e saj shndriste.



... Incidenti që i ndodhi babait tim, po në atë vit që linda unë, meriton të kujtohet këtu.

Siç e thashë, ai frekuentonte elitën shkodrane. Një mbrëmje, para se të kthehej në shtëpi, po qëndronte në grup me disa shokë në krye të rrugës që, përballë ish Bashkisë (Beledijes), çonte në Perash ku ne banonim. Këtë rrugë e quanim Rruga e Spitalit, meqë në këtë rrugë ishte ndërtesa e spitalit që kishte ndërtuar dhe administronte Austria...

Një bej shkodran (nuk do t'ia them emrin dhe arësyeja do të dalë më poshtë), me dashje, bëri që t'i harbohej kali dhe shkoi e i ra babait tim duke e rrëzuar përdhé ... Mama më thoshte se beu e kishte bërë padashje dhe një qëndrim të tillë mban për këtë fakt edhe gazeta që botonte Dom Ndoc

**TESTAMENT SHPIRTNOR**

***ÇDO DHIMBJE KAM PRANUE***

***EDHEPSE M'DHA TRISHTIM***

***HARË KA QENË PËR MUE***

***SEPSE PËRHERË***

***ASHT DHIMBJA DASHUNI***

***ASHT DASHUNIA GËZIM***

***GËZIMI ASHT RINI***

***RINIA ASHT PRANVERË***

***Romë, 9 gusht 1994***



Shkodër, 1945



*(Mbrapa Injaci ka shkruar:)*  
Viti shkollor 1946-1947. Trupi mësimit dhe nxënësit e Gjmnazit të Gjirokastrës.  
Thoma Papapano dhe unë jemi me kostume të qarta.



*(Mbrapa Injaci ka shkruar:)*

Këtë foto e kam bërë në Institutin e Shkencave, 10 prill 1949



Në manifestimin e 1 Majit 1963.

Nga e majta: Henrik Lacaj, Daniel Radiqi, Pashko Geci, Injac Zamputti





Kampionati XX Jubilar i Shahut 1-17 shtator 1965. Foto e bërë para fillimit të ndeshjeve, ora 16, dt. 1.IX.1965. Nga e majta në të djathtë, në këmbë: Vangjel Adhami, Nexhmi Kadriu(inspektor), Xhafer Çausi(arbitër),Gaspër Shoshi(arbitër), Bujar Hoxha(arbitër), Zef Ashta (arbitër), Injac Zamputti(arbitër), Teodor Siliqi, Gaspër Simoni, Fatos Omari, Ylvi Pustina, Floran Vila, Hysni Pëllumbi, Eqrem Konçi. Ulur: Kujtim Lloshi, Neritan Babamusta, Muharrem Ibrahim, Esat Duraku, Jovan Kristiqi, Ihsan Lezha, Mendim Veizaj, Kadri Zhulali.



Në Konferencën II Albanologjike 14.I.1968



Pesë vajzat e Injacit me bashkëshortët  
mbledhur për martesën e vëllait të tyre Jozefit me Luiza Muzhanin.  
Nga e majta në të djathtë: Maria me Musa Vyshkën, Nini me Albert Pistullin, Alda me Pal  
Dushin, Karmela me Sopot Haçin, Alfreda me Viron Skelën. Tiranë, 04.08.1974



Tiranë, 01.06.1979  
Injaci me nipin, Marinin, të veshur ushtar.



Injaci e Roza. Tiranë, 12.01.1980



Injaci e Roza me djalin, Jozefin,  
nusen, Luizën dhe me dy nipat, Marinin e Rozanin.  
Tiranë, 12.01.1980



Tiranë, Maj 1991.  
Injaci dhe, pranë tij, e pandara, gruaja Roza.



Në këndin e tij, në tryezën e vogël të punës.  
Tiranë, maj 1991



Injaci me Padre Santuccin, Tiranë, dhjetor 1992.



Injac Zamputti – Romë, 31.12.1993



Injaci me familjen e tij – Romë, 31.12.1993



Takim mbas 54 vjetësh. Romë, 25.11.1994.

Një ditë para se D. Mikel Koliqi të shugurohej Kardinal.  
 Nga e majta në të djathtë: Luiza, nusja e djalit, mbesa e D.Mikelit;  
 Antonieta, vjehrra e djalit, motra e D. Mikelit;  
 D. Mikel Koliqi, Injac Zamputti, Roza, e shoqja e Injazit  
 dhe Jozefi, djali i Injazit.



Injaci me shoqen e pandarë të jetës, Rozën.  
Tivoli, 12.02.1995. (85 vjetori i lindjes së tij).



Injaci me familjen e tij në festën e 20 vjetorit të nipit, Marinit.  
Nga e majta në të djathtë: Marini, nipi; Injaci; Roza, e shoqja;  
Jozefi, i biri; Luiza, nusja; Rozani nipi.  
Tivoli, 12.09.1995



Tivoli, 12.02.1997

Një bisedë e përzemërt midis babës dhe djalit.  
(87 vjetori i lindjes)